

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44.14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 51, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-557/1 datë 04.02.2025 dhe Konkluzionin ark.nr. 02-737/6 datë 24.02.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 8-të mbajtur më 24.02.2025, miratoj si vijon:

Aktvendim për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik

1. PUBLIKISHJT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë, për shkelje të kryer nga neni 51, paragrafit (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), në atë mënyrë që transmetuesi, në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuar më 28 janar 2025, nuk ka ofruar informacion që duhet t'u vinte në dispozicion përdoruesve.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr. 10-557/1 datë 04.02.2025, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi me Shtojcë nr.1.

2. DETYROHET SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë, që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i paraqitur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (Agjencia).

Arsyetim

Agjencia, në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (LSHMAAV), është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të mediave nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për media, LSHMAAV dhe Rregulloret e miratuara në bazë të tij.

Në përputhje me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesit) ndërmerr masë - paralajmërim publik në rastet kur është kryer cënim ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me leje dhe akte tjetër të Agjencisë.

Në pikën 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës, është përcaktuar se për shkeljet e konstatuara në vitin aktual, për të cilat janë shqiptuar masa në vitin paraprak, Këshilli i Agjencisë sërish do të shqipton masë paralajmërim publik sipas afateve të përcaktuara në Udhëzim.

Në përputhje me nenin 51, paragrafit (1) të LSHMAAV, ofruesit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuale duhet t'u ofrojnë përdoruesve të tyre qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme së paku për të dhënat në vijim: emrin e ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizual, përkatësisht emërtimin, shenjën mbrojtëse ose shenjën personale të identifikimit të shkurtuar si (avizo, logo ose të ngjajshme); adresën e zyrës qendrore të ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audioviziv; të dhëna për kontakt të ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audioviziv (numër telefoni, e-mail adresë dhe/ose ueb-faqe, personi kontaktues për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe, nëse është e mundur, të organit rregullator kompetent.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 4 shkurt 2025, ka kryer mbikëqyrje të kontrollit administrative (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë, transmetuar me datë 28.janar 2025, në nivel lokal, ku është konstatuar se edhe përkundër Aktvendimit për shqiptimin e masës – vërejtje publike PA1 03-342 datë 26.12.2025, për shkelje të nenit 51, paragrafi (1) të LSHMAAV, SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë nuk ka mënjanuar shkeljen, përkatësisht vazhdon të kryejë të njëjtën shkelje të LSHMAAV.

Gjegjësisht, mbikëqyrja konstatoi se më 28 janar 2025, SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë nuk ka ofruar informacion që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve, përkatësisht nuk u ka lejuar qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershme së paku për të dhënat në vijim: emrin e plotë të ofruesit të shërbimit mediatic audiovizual; adresën e selisë së ofruesit të shërbimit mediatic audioviziv; të dhëna për kontakt (numër telefoni, e-mail adresë dhe/ose ueb-faqe; personi përgjegjës për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe për organin rregullator kompetent.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-557/1 datë 04.02.2025, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në përputhje me nenin 23, paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë me datë 06.02.2025, dërgoj Shkresë ark.nr. 10-557/2 datë 06.02.2025, me të cilën i dorëzoi dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-557/1 datë 04.02.2025, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 13.02.2025. Në afatin e paraparë SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë nuk është deklaruar për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë, në seancën e mbajtur më 24.02.2025, shqyrtoi lëndën Raport me Shkrim dhe konstatoi që ndaj SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë, t'i shqiptohet masë masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, dhe në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20 dhe neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 51, paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pikat 6 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-557/1 datë 04.02.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-737/6 datë 24.02.2025, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur me datë 24.02.2025, miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmëron SHTR TV NJUZ SHPKNJP Kumanovë dhe detyrohet, që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit, të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i paraqitur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në përputhje me nenin 24, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër tij transmetuesi ka të drejtë padie për iniciimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit..

Bazuar nga sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-557/1 datë 04.02.2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për fillimin e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.